



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

“SUPERVIZIONI I MIRËMBAJTJES SË SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ-
DELVINE, LOT-7 (TUNELI)”

TIRANË 2023



TIRANË 2023

1. Hyrje

1.1 Vendi Përfitues

Republika e Shqipërisë.

1.2 Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) do të jetë Autoriteti Kontraktues ose Klienti.

1.3 INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Institucioni Përgjegjës për politikat e transportit në Shqipëri është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MIE) dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) është Agjensia Përgjegjëse për menaxhimin dhe implementimin e Rrjetit Rrugor Kombëtar. Ajo do të fillojë implementimin e kontratës së “Mirëmbajtjes së segmentit rrugor Kardhiq-Delvine, Lot-7 (Tuneli)”.

Me fondet e Buxhetit të Shtetit për vitin 2023 e në vazhdim është parashikuar të kryhet Mbikqyrja e Punimeve në objektin : “Mirëmbajtjes së segmentit rrugor Kardhiq-Delvine, Lot-7 (Tuneli)”. Për këtë qëllim, i kërkohet Mbikqyrësit të Punimeve të kësaj Kontratë të kryejë mbikqyrjen e këtij objekti me Fondin Limit të Mbikqyrjes së përlllogaritur nga Klienti / ARSSH.

1.4 PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I PROJEKTIT

Objektivi kryesor i Qeverisë Shqiptare në Sektorin e Transportit është edhe ndërtimi i segmentit rrugor Kardhiq-Delvinë (33km) i cili lidh qytetin e Gjirokastrës dhe Sarandës. Ky është një projekt transformues për zhvillimin e infrastrukturës me impakt në ekonominë dhe turizmin e vendit për në bregdetin e Jugut. Kjo rrugë është cilësuar një nga akset më prioritare, që shkurton në 3 orë kohën e udhëtimit nga Tirana deri në Sarandë, duke i dhënë një hov të mëtejshëm turizmit.

Ky projekt do të ndihmojë në lehtësimin e trafikut ndërmjet kryeqytetit të Shqipërisë dhe qytetit të Sarandës, që konsiston në reduktimin e kohës së udhëtimit, reduktimin e numrit të aksidenteve dhe përmirësimin e sigurisë rrugore, duke evituar kështu kalimin nga Qafa e Skërficës, e cila evidentohet si një rrugë mjaft e vështirë në një terren malor.

Loti.7 në të cilin ndodhet Tuneli Skërficës përfaqëson aksin rrugor i cili ndodhet në një distancë 8 km në perëndim të qytetit të Gjirokastrës. Loti.7 ndodhet nga km 6+150- km 8+760. Gjatësia Totale e Lotit.7 është 2,610m (në të cilën përfshihet 1.314m rrugë e asfaltuar). Terreni që përshkon ky lot është kodrinor dhe malor dhe në përgjithësi seksioni tërthor i rrugës është në gjurmim dhe një pjesë e tij në dalje të tunelit është në mbushje.

Ky është segmenti me kushte më të vështira si nga ana ndërtimore dhe gjeologjike. Qafa e Skërficës është e rrethuar me male të larta që janë të zhveshura nga bimësia.

Karakteristikat Gjeometrike të veprës:

Karakteristikat Gjeometrike të objektit:

- **Tunelit të Skërficës** me gjatësi 1.347,5m, me një tub (galeri) dhe ka dy korsi lëvizjeje (vajtje –ardhje).
- **Tunelit SOS** me gjatësi L=732m (km 6+150-km 7+650).

Sasia e trafikut që lëviz përgjatë tunelit është rritur dhe shumëfishohet në periudha të veçanta të rasteve të festave apo dhe pushimeve verore e dimërore.

Ky segment rrugor ka përfunduar fazën e ndërtimit në fund të Dhjetorit/2022 është kolauduar dhe aktualisht është në periudhën e Garancisë së Defekteve e cila zgjat 2 (dy) vjet.

Me përfundimin e periudhës së Garancisë së Defekteve të këtij objekti, Kontraktori aktual i implementimit të veprës, do të dorëzojë tek Punëdhënësi por pa u kufizuar të gjithë setin e plotë të pajisjeve elektro-mekanike, aparaturave, manualët përkatëse, etj.

Mbikqyrësi i Mirëmbajtjes së Tunelit (përfaqësues i Punëdhënësit) do të asistojë/monitorojë procesin e marrjes në dorëzim të këtij inventari nga Kontraktori i Mirëmbajtjes dhe Monitorimit

të Tunelit, i cili do të jetë pjesë integrale e pajisjeve dhe makinerive të tunelit në vazhdimësi.

1.5 – OBJEKTIVI KRYESOR I MBIKQYRËSIT

Nisur nga fakti që, “Mirëmbajtja e segmentit rrugor Kardhiq – Delvine, Lot-7 (Tuneli)” është një kontratë shërbimi me rëndësi të vecantë bazuar në Ligjin 158/2013, lidhur me sigurinë e tuneleve rrugore, Mbikqyrësi duhet të :

- Ndhimojë Klientin (ARRSH) me qëllim kryerjen e detyrave të supervizimit të kontratës së “Mirëmbajtja e segmentit rrugor Kardhiq – Delvine, Lot-7 (Tuneli)”.
- Sigurojë një staf prej inxhinierësh të kualifikuar dhe profesionistë, të cilët duhet të jenë kompetent në kryerjen e të gjitha detyrave të mbikëqyrjes, në bazë të përgjegjësive dhe të kompetencave që do të delegohen nga Klienti.
- Sigurojë kontratën duke verifikuar se shërbimet e dakortësuara janë përmbushur, si dhe i gjithë legjislacioni është respektuar.

1.6 – DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E MBIKQYRËSIT

Në realizimin e objektivave për implementimin e kontratës së shërbimit të objektit: “Mirëmbajtja e Pajisjeve dhe Operimit të Tunelit”, Mbikqyrësi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

Të sigurojë një Plan Pune i cili do të përshkruajë metodologjinë e propozuar në përputhje me Termat e Referencës (ToR). Gjithashtu:

- Shqyrton dhe vërteton garancinë e performancës së Operatorit të Tunelit
- Shqyrton dhe vërteton Policinë e Sigurimit të Operatorit të Tunelit
- Rishikon listën e organizimit dhe stafit të përgjithshëm të Operatorit të Tunelit, duke përfshirë:
 - Cilësinë dhe numrin e stafit - pajtueshmërinë me të dhënat, kualifikimet dhe kërkesat
 - Planet e pajisjeve-cilësinë
 - Organizimi / vendndodhja e zyrave dhe magazinave
 - Rishikon Programin e Performancës së Operatorit të Tunelit në vazhdimësi
 - Mobilizon Personelin kyç të Operatorit të Tunelit
 - Rishikon të dhënat nga Operatori të :
 - Planit të Procedurave të Emergjencës dhe Kontigjencës
 - Planit të Menaxhimit të Trafikut
 - Planit të Sigurimit të Cilësisë
 - Planit të Sigurisë së Shëndetit
 - Planit të Mbrojtjes së Mjedisit

Gjithashtu, përgjegjësia e Mbikqyrësit në këtë fazë do të përfshijë edhe detyrat e mëposhtme:

- Verifikimin e instalimit të sheshit të Operatorit të Tunelit
- Nën kontraktorët e propozuar me miratimin e ARRSH-së
- Të vlerësojë përgjegjshmërinë e Operatorit të Tunelit në masat e marra për menaxhimin e kontratës
- Propozimet e Operatorit të Tunelit për menaxhimin e sigurisë dhe dispozitave të trafikut në rrugë, dhe sigurinë në vëndin e punës
- Propozimet e Operatorit të Tunelit për sigurinë operationale në komunikacion për përdoruesit e rrugës
- Planin e Operatorit të Tuneli për Mbrojtjen e Mjedisit
- Programet e Punës të bazuara në burimet e propozuara, dhe programet e përditësuar të punës së Operatorit të Tunelit
- Sasitë dhe llogaritjet e vendosura nga Operatori i Tunelit
- Përgatitjen e dokumentave të menaxhimit të kontratës
- Krahasimin e punës së kryer në fakt nga ai i paraqitur në propozimin dhe diskutimin me Kontraktorin
- Çdo aktivitet tjetër në lidhje me miratimin dhe rishikimin e metodave të punës si dhe metodat e menaxhimit.
- Kur termat janë për t'u rishikuar, Menaxheri i Projektit të Mbikqyrësit ose do t'i pranojë ashtu siç janë ose do të theksojë të gjitha defektet / mangësitë në propozimet e Kontraktorit dhe do të asistojë për të ndihmuar Kontraktorin, sipas nevojës, në përgatitjen e një produkti me të pranueshëm nga kontrata.

Mbikqyrësi i Tunelit ka për detyrë gjatë kontratës:

- Të mbikqyrë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, Operatorin këtej e tutje i quajtur “Menaxheri i Tunelit”, për të garantuar mbi të gjitha sigurinë, efektivitetin dhe eficientë në punë si dhe operimin sa më ekonomik të tunelit dhe aksesit të tij në përputhje me qëllimet e Direktivës së BE 2004/54/EU mbi kërkesat minimale të sigurisë për tunelet e Rrjetit Rrugor Trans-Europian si dhe Ligjit Nr.158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore” në Republikën e Shqipërisë.
- Të mbikqyrë duke siguruar mirëmbajtje efektive, cilësore dhe ekonomike për makineritë operuese dhe të gjitha punimet e montimit që janë të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës në tunel.
- Të ushtrojë të gjithë kujdesin për të mbrojtur interesat e Klientit, për të siguruar mbikqyrjen dhe kontrollin e këtij shërbimi mirëmbajtjeje për të shmangur dukuritë e çrregullimeve gjatë kontratës.
- Të garantojë një zbatim në kohë të operimeve në tunel dhe përdorimin efikas të burimeve financiare, si edhe mbajtjen në prani të vazhdueshme të personelit të tij në vëndin e punës.

- Të jetë përgjegjës për verifikimin e mobilizimit të Operatorit të Tunelit në objekt, lidhur me të paktën burimet që ai është angazhuar për të siguruar në ofertën e tij dhe që burimet e siguruar janë të mjaftueshme për të mbajtur normat e tij të programuara deri në ditën e përfundimit.
- Të jetë përgjegjës për të siguruar që Operatori Tunelit përmbush detyrimet e tij për të garantuar raporte mujore të besueshme dhe të plota mbi ecurinë e shërbimit, duke theksuar çdo moment shkaqet për vonesat apo ndonjë crregullim tjetër në ecurinë e rregullt të punës.
- Të mbajë takime të rregullta mujore të progresit, në të cilat Operatori Tunelit duhet të paraqesë raportin e tij mujore progresiv. Të gjitha aspektet e Raportit të Progresit do të diskutohen dhe do të mbahen me proces-verbale të rregullta dhe kopjet e proces-verbalit do t'i dërgohen Kontraktorit. Proces-Verbalit duhet të përmbajë veprimet që do të ndërmerren nga të dy palët. Pas kësaj, Mbikqyresi do të kontrollojë që veprimet që duhet të ndërmerren nga të dy palët janë zbatuar në mënyrë korrekte.
- **Të mbikqyrë Operatorin e Tunelit në garantimin e:**
 - i. Kostove për gjeneratorët me qëllim furnizimin pa ndërprerje me energji elektrike.
 - ii. Furnizimin dhe vendosjen e çdo makinerie shtesë/zëvendësuese që mund të nevojitet për ecurinë e shërbimeve në tunel (subjekt i miratimit të Punëdhënësit).
 - iii. Furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve, impianteve, sistemeve dhe pjesëve konsumuese. (subjekt i miratimit primar të Punëdhënësit).
 - iv. Ruajtjen e sigurtë, rinovimin dhe magazinimin e kabinave të kontenierëve si dhe ndërtesave të përkohshme që janë pozicionuar në qëndren e kontrollit të tunelit.
 - v. Kontrollin, mirëmbajtjen dhe shërbimet për linjën 110/35/6 KV, Fiderin e Kardhiqit, që furnizojnë tunelin nga Nënstacioni Gjirokaster e Vjetër
 - vi. Kontrollin, mirëmbajtjen dhe pajisjen me sinjalistikën e duhur të tunelit.
 - vii. Ruajtjen e sigurtë të nënstacionit të tunelit me të gjithë aparaturat dhe pajisjet që përmban (transformatorët, gjeneratorët, ups e tjerë).
- Të mbikqyrë në lidhje me përmbajtjen e objektivave të përshkruara më lart, në paraqitjen e një programi pune dhe procedura të cilat do të sigurojnë që:
 - I. Operatori i Tunelit, të marrë direktiva nga Drejtori i Përgjithshëm i ARRSH-së, i cili deri në një njoftim tjetër, do të njihet si Autoriteti Administrativ (Punëdhënësi), dhe Menaxheri i Tunelit të ketë autoritet dhe të përmbushë gjithë përgjegjësitë në përputhje me Direktivën e BE 2004/54/EU mbi kërkesat e sigurisë për tunelet në Rrjetin Rrugor

Trans-European dhe Ligjit Nr 158/2013 “Për Sigurinë në Tunelet Rrugore” në Republikën e Shqipërisë.

- II. Operatori i Tunelit të administrojë tunelin në përputhje me Direktivën e propozuar të Bashkimit European dhe çdo përjashtim operativ i pashmangshëm nuk do të zbatohet ose bëhet efektive, pa miratimin me shkrim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), si autoriteti përgjegjës për zbatimin e të gjithë aspekteve të sigurisë në tunelet rrugore.
- III. Operatori i Tunelit të propozojë, kryejë dhe rregjistrojë një program të rregullt mbi punimet e mirëmbajtjes dhe punimet për zëvendësimin e pjesëve të konsumueshme së bashku me provat dhe testimet e pajisjeve, sistemit SCADA si dhe pajisjeve të tjera operuese/monitoruese me qëllim garantimin e funksionimit të përhershëm.
- IV. Operatori i Tunelit të koordinojë aktivitetet e tij me ato të Shërbimit Zjarrfikës Lokal si dhe duke mbajtur kontakte me shërbimet e policisë së zonës, në mënyrë që dhe këto dy shërbime të tjera të veprojnë së bashku me Menaxherin e Tunelit si një njësi e bashkuar e cila do të jetë efektive në ndalimin e çdo mjeti mbi normat e lejuara, ose të pasigurtë në tunel, kontrollin e sigurtë të fluksit të trafikut dhe të përgatitur ndaj çdo situatë emergjente.
 - Operatori i Tunelit ti përgjigjet çdo kërkesë të gjithë institucioneve dhe autoriteteve të interesuara me objektin. Këto institucione do të jenë, por pa limituar, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) dhe furnizuesit e tjerë të shërbimeve, Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), autoritetet rajonale, spitalet rajonale dhe shërbimi i ambulancës, degët e ndryshme të forcave të policisë, Drejtoria e Ndërtimit dhe Mirëmbajtjes në ARRSH si edhe drejtoritë administrative rajonale dhe kombëtare.
 - Operatori i Tunelit të justifikojë konsumin e karburantit për vënie në punë të gjeneratorëve rezervë në kohën kur energjia kryesore mungon, ose kur ka luhajtje jashtë kufijve të funksionimit normal të aparaturave dhe pajisjeve, si dhe mbajtjen e tyre gjatë gjithë kohës në gjendje gadishmërie.
- V. Bazuar në këtë koncept të përgjithshëm, Mbikqyrësi është e nevojshme të ndihmojë Autoritetin Rrugor Shqiptar (Klientin) në këto çeshtje :
 - Vlerësimin dhe miratimin e mobilizimit dhe organizimit të procedurave të operatorit të mirëmbajtjes së tunelit
 - Mbikqyrjen e mirëmbajtjes së të gjithë pajisjeve dhe sistemeve operuese të tunelit në përputhje me Planin e miratuar për Sigurimin e Cilësisë

- Mbikqyrjen e funksionimit të pajisjeve të tunelit duke përfshirë testimin për cilësinë dhe mirëfunksionimin e tyre
- Mbikqyrjen në rast emergjence, nëse kjo konsiderohet e domosdoshme nga Menaxheri Primar i Operimeve të Tunelit, në cilësinë edhe të Oficerit të Sigurisë dhe Menaxherit të Tunelit dhe/ose nëse mund të kërkohet nga Punëdhënësi, dhe të rihapë tunelin për trafikun publik pas marrjes së autorizimit nga Punëdhënësi (ARRSH), të shpërndajë njoftimet për mbylljen dhe rihapjen tek autoritetet dhe organizatat e interesuara dhe të sigurojë hapjen e sigurtë të tunelit, sipas regjimeve të sigurimit të cilësisë së funksionimit dhe mirëmbajtjes së pajisjeve;
- Mbikqyrjen (në përputhje me Artikullin 13 të Direktives së BE-së), të gjithë analizave për rreziqet që mund të dalin gjatë fazave të ndryshme të funksionimit dhe operimit të tunelit, duke plotësuar kështu një Rregjistër Risku të përgatitura nga Menaxheri i Operimeve të Tunelit.
- Autorizimin e ekzekutimit të punimeve emergjente dhe të fondit të kontigjencës.
- Kryerjen e inspektimeve formale dhe joformale në objekt.
- Përcaktimin dhe certifikimin e shumave për t'u paguar në baza mujore për punimet e mirëmbajtjes dhe operimit të tunelit
- Raportimin në ARRSH mbi një bazë të rregullt të aktiviteteve të mirëmbajtjes e operimit të tunelit.
- **Mbikqyrësi do monitoroj Operatorin e Tunelit për përgatitjen dhe dorëzimin në fund të projektit të të gjithë manualeve të operimit, raportet, protokollet e mirëmbajtjes, inventarët e magazinave, menaxhimin e rreziqeve dhe sistemet e emergjencës që kërkohen për vazhdimësinë e operimit të tunelit.**

Për të përmbushur këto kërkesa, Menaxheri i Projektit të Mbikqyresit do të kryejë një metodologji me detyra të detajuara brenda Propozimit e tij Teknik dhe këto detyra të detajuara do të përfaqësojnë pjesën më të madhe të detyrave të cilat priten të kryhen nga Mbikqyrësi.

1.7.-DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E STAFIT TË MBIKQYRESIT

1) Menaxheri Drejtues i Mbikqyrësit në Tunel duhet:

- Të mbikqyrë koordinim me shërbimet e emergjencës, të stimulojë përgatitjen e skemave të operimit për raste emergjente (zjarr në tunel, aksident i rëndë etj);
- Të mbikqyrë planifikim, zbatim dhe vlerësimin e operimeve (ndërhyrjeve) të emergjencës;
- Të mbikqyrë përkufizimin e skemave të sigurisë dhe të sigurojë që në përputhje me Artikullin 4, Klauzola 6 e Direktivës së BE, janë kryer gjithë detyrat e mëposhtme:
 - Testimi dhe inspektimi në mënyrë të rregullt i tunelit dhe përgatitja e kërkesave të sigurisë;
 - Vendosja dhe përcaktimi i gjithë skemave organizative dhe operuese (duke përfshirë planet e kundërpërgjigjes në rastet e emergjencës), për trajnimin dhe pajisjen e shërbimeve të emergjencës;

- c) Konturimi i plotë i procedurës për mbylljen e menjëhershme të tunelit në rast emergjence;
- d) Zbatueshmëria e gjithë masave që duhen marrë për uljen e rrezikut.
- e) Të mbikqyrë Sipas Artikullit 13 të Direktivës së BE-së, dhe VKM nr.648 dt.22.07.2015 "Për miratimin e kritereve të caktimit të menaxherit, Oficerit të Sigurisë e inspektorit të autorizuar dhe të metodologjise së analizës së riskut për sigurinë e tuneleve rrugore", përgatit analizat e rreziqeve dhe shmangien e tyre në faza të ndryshme të hapjes së tunelit, marrja në konsideratë e gjithë faktorëve të projektimit dhe kushtet e trafikut që ndikojnë në sigurinë, duke përfshirë karakteristikat dhe llojin e trafikut, gjatësinë e tunelit, gjeometrinë e tunelit dhe parashikimin e numrit të automjeteve të rënda në ditë (analizat do përsëriten në rastin e ndonjë ndryshimi të konsiderueshëm në trafik nga analizat e parashikuara.
- f) Pjesëmarrja në vlerësimin e aftësive operuese të sistemit SCADA, në mënyrë që të garantohet mbarëvajtja e sistemit operues në mënyrë sa më efektive dhe të dobishme;
- g) Të verifikojë që stafi operues dhe personeli i shërbimeve të emergjencës janë trajnuar dhe merr pjesë në organizimin e veprimeve të rregullta që garantojnë kundërpërgjigje sa më korrekte gjatë rasteve të emergjencës;
- h) Të marrë pjesë në organizimin dhe kryerjen e trajnimit të operatorëve që do të trajnohen dhe të skuadrave të mirëmbajtjes;
- i) Të japë këshilla mbi vënien në punë të strukturës së tunelit, pajisjeve dhe operimin e tunelit;
- j) Të verifikojë që struktura e tunelit dhe pajisjet e tij mirëmbahen dhe riparohen;
- k) Të marrë pjesë në vlerësimin e çdo incidenti apo aksidenti të rëndë ashtu siç ilustron në Artikullin 5(3) dhe (4) të Direktivës së BE.

2) **Mbikqyrësi i Mirëmbajtjes së Makinerive (Ing.Mekanik /Elektrik) duhet:**

- a) Të marrë përsipër përgjegjësitë për mirëmbajtje të vazhdueshme të pajisjeve dhe sistemeve që punojnë në tunel si dhe cilësi të garantuar të tyre.
- b) Duke patur parasysh faktin që shpesh herë do të mund të ketë edhe anomali në funksionimin e furnizuesve të energjisë, të ruajë një komunikim të vazhdueshëm me kompaninë e shpërndarjes së energjisë në mënyrë që të njoftohet sa herë do ketë situata me mungesë energjie, dhe të sigurohet që në rast mungese energjie të funksionojnë furnizimi me energji me anë të gjeneratorëve;
- c) Në rastet kur do të nevojitet zëvendësimi i ndonjë pajisje apo instalimi i ndonjë pajisje/sistemi të ri në funksion të tunelit, do nevojiten gjatë fazave të këtyre shërbimeve të ruajë një bashkëpunim sa më të ngushtë me ekipet e punës apo nënkontraktorë të mundshëm për t'u harmonizuar sa më mirë për të shmangur konfliktin ndërmjet punimeve të instalimit me ato të ndërhyrjes në tunel apo të mirëmbajtjes së makinerive.
- d) Të kontrollojë dhe të sigurojë që pjesët e këmbimit të makinerive që mbahen në magazinim, të jenë të ruajtura mirë dhe në gjendje që të mbajnë tunelin në kushte shumë të sigurta pune gjatë gjithë kohës;

- e) Të regjistrojë dhe të arshivojë të dhënat dhe rezultatet e dalta nga inspektimet e pajisjeve dhe sistemeve, si edhe gjatë mirëmbajtjes së tunelit.

Supervizori duhet të monitoroj Operatorin e Tunelit (Kontraktorin) ne certifikimin e zerave (ii-vii) te Seksionit B3 te Termave te References te cilat do te paguhen a) vetem mbas paraqitjes se Flete Garancise (ne te cilen parashikohet periudha dhe specifikimet perkatese) te pajisjeve /aparaturave te ndryshme te cilat do te duhet te zevendesohen ne rast mosfunksionimi dhe b) mbas perfundimit te periudhes se Garancise se Difekteve nga Kontraktori aktual i cili e ka obligim kontraktual (2vjet)

1.8- LISTA E RAPORTEVE / DOKUMENTAVE DHE PROGRAMI I SHPËRNDARJES

Më poshtë janë përcaktuar raportet dhe dokumentat që duhen përgatitur, frekuenca e tyre, paraqitja në kohë, si dhe tema e përmbytjes së tyre.

Mbikqyrësi i mirëmbajtjes së pajisjeve dhe operimit të tunelit do të dorëzojë te Punëdhënësi (ARRSH) raportet dhe dokumentacionin, përkatësisht si më poshtë:

- (a) **Raporti fillestar**- me një afat fundi i muajit të parë, pas lidhjes së kontratës.

Në këtë raport do të pasqyrohen të gjitha të dhënat e stafit të angazhuar për realizimin e kontratës, strategjitë për përmbytjen e detyrave të kontratës, problemet e hasura me gjendjen aktuale të sejcilit prej sistemeve të tunelit, strategjitë për përballimin e situatave emergjente, e tjerë (3 kopje në gjuhen shqipe).

- (b) **Raportet Mujore** - fillojnë nga fundi i muajit të parë të plotë nga data e nënshkrimit të kontratës ndërmjet Mbikqyresit dhe Punëdhënësit (ARRSH) -(3 Kopje ne Shqip)

Dorëzimi: 1 javë pas ditës së fundit të çdo muaji.

Raportet Mujore do të japin të dhëna për personelin sipas turneve (përfshirë policinë, brigadat e zjarrëfiksive dhe ekipet e mirëmbajtjes), ngjarjet, dëmtime/defekte të pajisjeve, incidentet dhe veprimet e ndërmarra për kontrollin e tunelit. Përdorimi i energjisë është çështje e rëndësishme, prandaj ndërprejet e furnizimit me energji dhe përdorimi i gjeneratorëve duhet regjistruar.

Raporti i Mbikqyresit të Tunelit, do të përfshijë Raportin Mujor të Oficerit të Sigurisë, i cili duhet të nënvizojë çdo zonë problematike dhe njëkohësisht raportet specifike mbi ndonjë aksident dhe/ose lëndime të personave. Mbikqyrësi do të raportojë

detaje të ndonjë rasti mosfunksionimi të kënaqshëm të ndonjë pajisjeje apo sistemi dhe propozime për ndonjë modifikim të dobishëm.

Raporti i Mbikqyresit të Tunelit do të regjistrojë të dhëna për mirëmbajtjen e

planifikuar ose të rastit që është kryer gjatë muajit dhe riparimin dhe/ose zëvendësimin e ndonjë pajisjeje. Raporti duhet të japë një inventar të pjesëve në magazinë.

Gjithashtu, aty do të raportohen edhe marrëdhëniet e Operatorit të Tunelit me Njësinë e Policisë e cila mbulon zonën e tunelit si dhe të gjithë autoritetet e tjera të përfshira në këtë shërbim, do të kryejë inspektime manuale fizike të përditshme në tunel. Frekuenca e këtyre inspektimeve do të përcaktohet nga vetë stafi drejtues i Operatorit të Tunelit në varësi të gjendjes, që mund të jetë edhe disa herë në ditë në rast avarie apo parashikimi të ndonjë situatë të rrezikshme që do të vlerësohet po nga stafi drejtues permanent në kontratë.

Në të njëjtën kohë, Mbikqyesi i Tunelit duhet të japë rekomandimet e tij në lidhje me operimin e tunelit në të ardhmen.

Mbikqyesi i Tunelit duhet të bashkëngjisë një model të Raportit Mujor në Raportin e tij Fillestar dhe ta modifikojë më pas mënyrën e raportimit në varësi të komenteve që mund të bëhen nga Punëdhënësi.

(c) Draft Raporti Përfundimtar

(3 Kopje në Shqip)

Dorezimi: 1 muaj para përfundimit të kontratës.

Draft Raporti Përfundimtar do të paraqesë një përshkrim nëse Kontrata ka qënë e suksesshme.

Raporti do të përfshijë ndërmjet të tjerave, por jo limituar, edhe informacionet e mëposhtme:

- Pasqyrë të përgjithshme të Kontratës për Funksionimin e Tunelit;
- Performancën e Kontratës në lidhje me Termat e Referencës;
- Shpjegime për ndryshime kundrejt Termave të Referencës;
- Shpenzime në lidhje me buxhetet fillestare;
- Shpjegime për ndryshimet kundrejt këtyre buxheteve;
- Numrin e burimeve njerëzore të punësuar gjatë kohëzgjatjes së Kontratës;
- Të përshkruajë në drejtim të fuqisë punëtore, kërkesave materiale dhe administrative, si edhe ndonje çështje tjetër që mund të ndihmojë Punëdhënësin në të ardhmen në lidhje me programet e mirëmbajtjes dhe funksionimit të tunelit;
- Dokumentacion të plotë me të gjitha të dhënat për Sistemet e Mirëmbajtjes dhe Garancisë së Cilësisë së funksionimit të Tunelit për të mundësuar dorëzimin e perpiktë të punëve për funksionimin e tunelit dhe përgjegjësi të mirëmbajtjes.

- Një listë kontrolli të aprovuar për funksionimin e tunelit dhe aktivitetet e mirëmbajtjes kundrejt të cilave do të punohet nga një Kontraktor tjetër që do të ndjekë funksionimin e Tunelit në të ardhmen.

(d) Raporti Përfundimtar

(3 Kopje në Shqip)

Dorezimi: Menjëherë pas përfundimit të afatit kontraktual ose pas komenteve të bera nga ARRSH mbi Draftin e Raportit Përfundimtar, cilido qoftë me i vonshmi.

Raporti Përfundimtar do të bazohet në Draft Raportin Përfundimtar, por duke përfshirë ndonjë koment/sugjerim të bërë nga palët recensuese (MTI, ARRSH).

3) Raportet zyrtare do të paraqiten të printuara dhe në mënyrë elektronike në CD/DVD.

1.9- Kohëzgjatja e Kontratës

Aktiviteti i Mbikqyresit do të vazhdoj paralel me mirembajtjen e objektit.

Zgjatja totale e Shërbimit të Mbikqyrjes do të **jetë 4 vjet (48muaj)**. Nje muaj para përfundimit të kontratës së implementimit të mirembajtjes, do të shërbej për kontrollin e kërkesës përfundimtare të pagesës dhe përgatitjen e raportit përfundimtar.

1.10-Personeli

Konsulenti duhet të sigurojë një ekip me përvojë në mbikëqyrje të kontratës së mirëmbajtjes, me kompetencë teknike dhe menaxheriale të provuar.

Gjuha e komunikimit në të gjithë dokumentacionet do të jetë gjuha shqipe.

Personeli Kyç

Duke marrë në konsideratë punën që do të kryhet, Konsulenti duhet të sigurojë, stafin e mëposhtëm kyç :

1) Nje (1) Menaxher Projekti me kohë të plotë (48 muaj) – Duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri ndertimi ose në inxhinieri mekanike(transport) si dhe eksperiencë të paktën 15 vjeçare në sigurinë rrugore, veçanërisht në administrimin e incidenteve rrugorë dhe inspektimin e sigurisë rrugore. Ai gjithashtu duhet të ketë njohuri për sistemet inteligjente të transportit që lidhen me administrimin e incidenteve.

2) Nje (1) Mbikqyres për pajisjet dhe makineritë e tunelit me kohë të plotë (29.3 muaj) - specifikisht në muajt e garancisë së objektit që do të mbikqyret gjatë periudhës së mirëmbajtjes mbikqyrësi do të inspektojë objektin 2(dy) herë në javë. Pas përfundimit të periudhës së garancisë mbikqyrësi do të jetë prezent çdo ditë në objekt.

Duhet të ketë edukimin arsimor në inxhinieri mekanike ose elektrike si dhe eksperiencë të paktën 15 vjeçare (me experiencë të mjaftueshme dhe të suksesshme në tunele e vepra të tjera të natyrës së ngjashme) i cili do jetë përgjegjës për të siguruar standartin e duhur të cilësisë së mirëmbajtjes të pajisjeve dhe sistemeve të tunelit.

1.11 - Mbështetja e Personelit, Pajisjet dhe Objektet që do të ofrohen nga Konsulenti

Pikat e mëposhtme do të sigurohen nga Konsulenti:

(i) **Facilitete per Kontratën** (duke përfshirë, shpenzime zyre, kancelari, tel etj), në një caktim kohe të plotë të Kontratës.

(ii) **1(nje) automjet , Makinë Tip 4x4 /Autoveturë për personelin kyc**, të jetë në dispozicion të Mbikqyresit ku llogaritet (karburant dhe mirëmbajtje automjeteve) në kohë të plotë të kontratës.

1.12 - TË DREJTAT E ARRSH-së.

ARRSH-ja ka të drejtë të kërkojë largimin e mbikëqyresit kur vërteton mangësi serioze në veprimtarinë e tij si:

- Mangësi në plotësimin e detyrave të përcaktuara ne ToR.
- Ndërprerje e paarsyeshme e kontratës së mirëmbajtjes së tunelit.
- Mangësi dhe tolerim të materialeve jashtë cilësisë së kërkuar, tolerim të punimeve te mirembajtjes jo me cilësinë e kërkuar, tolerim të pajisjeve jashtë kushteve teknike.

1.13 - MËNYRA E DHËNIES SË OFERTËS.

Oferta jepet në vleftë totale e zbërthyer në shpenzime për muaj/njeri dhe shpenzime të tjera të nevojshme për tu kryer.

1.14 - MËNYRA E PAGESËS.

Pagesa do të bëhet ne baza mujore e zbërthyer sipas shpenzimeve në muaj/njeri.

